# Revue de presse/ Press review

http://www.kultplus.com/index.php?id=5&l=2643 Kërko portal

- Libri



## "Gruaja e thyer" e de Beauvoir në shqip

Publikuar: 2014-04-19 12:10:41

**Vetë Beauvoir nuk e konsideronte veten si filozofe por pati një ndikim të rëndësishëm mbi ekzistencializmin dhe teorinë feministe. Ajo ka shkruar novela, romane, ese, biografi, një autobiografi dhe monografi mbi filozofinë, politikën dhe çështjet sociale. Midis të tjerash, ajo është shumë e njohur për romanet e saj "E ftuara" dhe "Les Mandarins", si edhe për veprën e saj eseistike "Seksi i dytë". Botimi në shqip i novelës "Gruaja e thyer", shqipëruar nga Amantia Kapo realizohet falë ndihmës financiare të Komisionit Europian.**

Kjo "grua e thyer" është një grua e martuar, e varur, e braktisur, e hedhur dhe e gjykuar nga gjenerata pasuese.
Me këto tre histori të mprehta mbi rënien e pasionit, Simone de Beauvoir na tërheq në jetën e tri grave, në moshë të mesme, të cilat përballen me kriza të papritura. Në tregimin që i jep edhe titullin librit, qetësia e heroinës shkërmoqet, kur ajo zbulon se bashkëshorti i saj ka një lidhje jashtëmartesore. Në "Koha e maturisë", një profesoreshë e suksesshme dhe lumturisht e martuar e gjen veten gjithmonë e më të pakënaqur për shkak të tërheqjes së djalit të saj për gruan e tij të re dhe vlerat e saj. Në "Monolog", një grua e pasur, e llastuar, që gjendet e vetme në Natën e Vitit të Ri, vjell furinë dhe

zhgënjimin e një jete në një zënkë bezdisëse. Këto tre pjesëza magjepsëse, të mbushura me mendjemprehtësinë e jashtëzakonshme të de Beauvoir-it, na zbulojnë shkrimtaren legjendare në nivelet e saj më të larta. Ajo i tregon personazhet e saja si qenie njerëzore dhe nuk i gjykon ato nga një piedestal moral; ajo nuk krijon heronj që do t’i shpëtojnë këto femra. Në një kohë kur libraritë janë të mbushura me romanca bukuroshesh njëzetecavjeçare që gjejnë lumturinë me “princin” e radhës, një libër i vërtetë dhe kompleks është një fllad i mirëpritur pranveror.




Për të gjithë lexuesit e mirë dhe që kërkojnë letërsi të kulluar. Për ato lexuese
që duan të thyejnë barrierat e mendimit të përbashkët. “Ne nuk lindim gra: ne bëhemi të tilla.. Asnjë fat biologjik, psikik, ekonomik nuk e përcakton trajtën që merr në gjirin e shoqërisë femra njerëzore; është tërësia e qytetërimit ajo që përpunon këtë produkt të ndërmjetëm midis mashkullit dhe tredhakut që ne e cilësojmë femërore.”
“Barazi mund të vendoset vetëm atëherë kur të dy gjinitë do të kenë të drejta juridike të
barabarta, por që të kryhet ky kapërcim duhet hyrja e gjithë gjinisë femër në industrinë
publike. Gruaja mund të emancipohet vetëm atëherë kur të arrij të marr pjesë në një
masë të madhe shoqërore në prodhim dhe kur të kërkohet, në një masë pothuaj
parëndësishme, për punët shtëpiake”.- shkruan Simone De Beauvoir simboli i erës së re, themeluesja e konceptit të gruas modernetë shek XX, e cila jetoi si e tillë dhe veproi si e tillë; e pavarur në krijimtari dhe në zgjedhjet e saj jetësore. Ajo jetoi dashurinë e saj të përjetshme me filozofin francez, Jean-Paul Sartre në mënyrë jokonvencionale. Lidhja e tyre ishte pasion, kreativitet, por pa e mohuar asnjëherë feminilitetin e saj, pa u ndalur asnjëherë në punën e vazhdueshme për të ngritur e debatuar për çështje të mëdha siç dhe e ka provuar në veprën e saj. Vetë Beauvoir nuk e konsideronte veten si filozofe por pati një ndikim të rëndësishëm mbi ekzistencializmin dhe teorinë feministe. Ajo ka shkruar novela, romane, ese, biografi, një autobiografi dhe monografi mbi filozofinë, politikën dhe çështjet sociale. Midis të tjerash, ajo është shumë e njohur për romanet e saj “E ftuara” dhe “Les Mandarins”, si edhe për veprën e saj eseistike “Seksi i dytë”. Botimi në shqip i novelës “Gruaja e thyer”, shqipëruar nga Amantia Kapo realizohet falë ndihmës financiare të Komisionit Europian. / **KultPlus.com**

---

DitaPress
Lajme Çdo çast Çdo ditë



# Librat e rinj

12:40 // April 21, 2014

**“Gruaja e thyer” – Simone de Beauvoir**




Me këto tri histori të mprehta mbi rënien e pasionit, Simone de Beauvoir na tërheq në jetën e tri grave, në moshë të mesme, të cilat përballen me kriza të papritura. Në tregimin që i jep edhe titullin e librit, qetësia e heroinës shkërmoqet, kur ajo zbulon se bashkëshorti i saj ka një lidhje jashtëmartesore. Në “Koha e maturisë”, një profesoreshë e suksesshme dhe lumturisht e martuar e gjen veten gjithmonë e më të pakënaqur, për shkak të tërheqjes së djalit të saj për gruan e tij të re dhe vlerat e saj. Në “Monolog”, një grua e pasur, e llastuar, që gjendet e vetme në natën e Vitit të Ri, vjell furinë dhe zhgënjimin e një jete në një zënkë bezdisëse. Këto tri pjesëza magjepsëse, të mbushura me mendjemprehtësinë e jashtëzakonshme të de Beauvoir-it, na zbulojnë shkrimtaren legjendare në nivelet e saj më të larta. Ajo i tregon personazhet e saja si qenie njerëzore dhe nuk i gjykon ato nga një piedestal moral; ajo nuk krijon heronj që do t’i shpëtojnë këto femra.

Përktheu: Amantia Kapo
Botimet: “Pegi”

---

MAPO ONLINE

## Tri gratë e Simone de Beauvoir

Nga Redaktor {19/04/2014}

Kjo “grua e thyer” është një grua e martuar, e varur, e braktisur, e hedhur dhe e gjykuar nga gjenerata pasuese.

Me këto tre histori të mprehta mbi rënien e pasionit, Simone de Beauvoir na tërheq në jetën e tri grave, në moshë të mesme, të cilat përballen me kriza të papritura. Në tregimin që i jep edhe titullin librit, qetësia e heroinës shkërmoqet, kur ajo zbulon se bashkëshorti i saj ka një lidhje jashtëmartesore. Në “Koha e maturisë”, një profesoreshë e suksesshme dhe lumturisht e martuar e gjen veten gjithmonë e më të pakënaqur për shkak të tërheqjes së djalit të saj për gruan e tij të re dhe vlerat e saj. Në “Monolog”, një grua e pasur, e llastuar, që gjendet e vetme në Natën e Vitit të Ri, vjell furinë dhe zhgënjimin e një jete në një zënkë bezdisëse. Këto tre pjesëza magjepsëse, të mbushura me mendjemprehtësinë e jashtëzakonshme të de Beauvoir-it, na zbulojnë shkrimtaren legjendare në nivelet e saj më të larta. Ajo i tregon personazhet e saja si qenie njerëzore dhe nuk i gjykon ato nga një piedestal moral; ajo nuk krijon heronj që do t’i shpëtojnë këto femra. Në një kohë kur libraritë janë të mbushura me romanca bukuroshesh njëzetecavjeçare që gjejnë lumturinë me “princin” e radhës, një libër i vërtetë dhe kompleks është një fllad i mirëpritur pranveror. Për të gjithë lexuesit e mirë dhe që kërkojnë letërsi të kulluar. Për ato lexuese

që duan të thyejnë barrierat e mendimit të përbashkët. “*Ne nuk lindim gra: ne bëhemi të tilla.. Asnjë fat biologjik, psikik, ekonomik nuk e përcakton trajtën që merr në gjirin e shoqërisë femra njerëzore; është tërësia e qytetërimit ajo që përpunon këtë produkt të ndërmjetëm midis mashkullit dhe tredhakut që ne e cilësojmë femërore.*”

“*Barazi mund të vendoset vetëm atëherë kur të dy gjinitë do të kenë të drejta juridike të barabarta, por që të kryhet ky kapërcim duhet hyrja e gjithë gjinisë femër në industrinë publike. Gruaja mund të emancipohet vetëm atëherë kur të arrij të marr pjesë në një masë të madhe shoqërore në prodhim dhe kur të kërkohet, në një masë pothuaj parëndësishme, për punët shtëpiake*”.- shkruan Simone De Beauvoir simboli i erës së re, themeluesja e konceptit të gruas modernetë shek XX, e cila jetoi si e tillë dhe veproi si e tillë; e pavarur në krijimtari dhe në zgjedhjet e saj jetësore. Ajo jetoi dashurinë e saj të përjetshme me filozofin francez, Jean-Paul Sartre në mënyrë jokonvencionale. Lidhja e tyre ishte pasion, kreativitet, por pa e mohuar asnjëherë feminilitetin e saj, pa u ndalur asnjëherë në punën e vazhdueshme për të ngritur e debatuar për çështje të mëdha siç dhe e ka provuar në veprën e saj. Vetë Beauvoir nuk e konsideronte veten si filozofe por pati një ndikim të rëndësishëm mbi ekzistencializmin dhe teorinë feministe. Ajo ka shkruar novela, romane, ese, biografi, një autobiografi dhe monografi mbi filozofinë, politikën dhe çështjet sociale. Midis të tjerash, ajo është shumë e njohur për romanet e saj “E ftuara” dhe “Les Mandarins”, si edhe për veprën e saj eseistike “Seksi i dytë”. Botimi në shqip i novelës “Gruaja e thyer”,  shqipëruar nga Amantia Kapo realizohet falë ndihmës financiare të Komisionit Europian.






## SIMONE DE BEAUVOIR

# “Gruaja e thyer”

**PËRKTHEU: AMANTIA KAPO**
**BOTIMET: “PEGI”**
**ÇMIMI: 700 LEKË**

Me këto tri histori të mprehta mbi rënien e pasionit, Simone de Beauvoir na tërheq në jetën e tri grave, në moshë të mesme, të cilat përballen me kriza të papritura. Në tregimin që i jep edhe titullin e librit, qetësia e heroinës shkërmoqet, kur ajo zbulon se bashkëshorti i saj ka një lidhje jashtëmartesore. Në “Koha e maturisë”, një profesoreshë e suksesshme dhe lumturisht e martuar e gjen veten gjithmonë e më të pakënaqur, për shkak të tërheqjes së djalit të saj për gruan e tij të re dhe vlerat e saj. Në “Monolog”, një grua e pasur, e llastuar, që gjendet e vetme në natën e Vitit të Ri, vjell furinë dhe zhgënjimin e një jete në një zënkë bezdisëse. Këto tri pjesëza magjepsëse, të mbushura me mendjemprehtësinë e jashtëzakonshme të de Beauvoir-it, na zbulojnë shkrimtaren legjendare në nivelet e saj më të larta. Ajo i tregon personazhet e saja si qenie njerëzore dhe nuk i gjykon ato nga një piedestal moral; ajo nuk krijon heronj që do t’i shpëtojnë këto femra.

FLATRA
06-2014 KOSOVO

# KËNDI I LIBRIT

## "ERA"

Kështu titullohet romani i autores Ilire Zajmi, i cili u promovua me rastin e Panairit të XVI të Librit që u mbajt në Prishtinë. Romani "Era" është roman që flet për dashurinë në kohë pushtimi. Një dashuri e zjarrtë mes një çifti që i mbijnë tragjit e jetës për shkak të rrethanave që mbretërojnë në vend. Një dashuri ëndërrore për personazhin kryesor, Erën që brakton dashurinë e jetës së saj për të realizuar një ëndërr. Për tu bërë nyjeje në rrethana kur lufta troket te porta e shtëpisë. "Era" është një roman për dashurinë, ndarjen, braktisjen, ikjen nga vendi. Një roman që lexohet me një frymë e me një fund befasues, të papritur kur jeta të jep një mundësi të bësh kthesën që se ke menduar kurrë. Romani "Era" është botuar nga shtëpia botuese "Bota shqiptare".







## "GRUAJA E THYER"

Është libri i autores Simone de Beauvoir, përkthyer nga Amantia Kapo, publikuar nga Botimet Pegi, në Tiranë. Me këto tre histori të mprehta mbi rënien e pasionit, Simone de Beauvoir na tërheq në jetën e tri grave, në moshë të mesme, të cilat përballen me kriza të papritura. Në tregimin që i jep edhe titullin librit, qetësia e heroinës shkërmoqet, kur ajo zbulon se bashkëshorti i saj ka një lidhje jashtëmartesore. Këto tre pjesëza magjepsëse, të mbushura me mendjemprehtësinë e jashtëzakonshme të de Beauvoir-it, na zbulojnë shkrimtaren legjendare në nivelet e saj më të larta. Ajo i tregon personazhet e saja si qenie njerëzore dhe nuk i gjykon ato nga një piedestal moral; ajo nuk krijon heronj që do t'i shpëtojnë këto femra. Sipas "The Sunday Herald Times "Ajo që të habit më shumë nga libri "Gruaja e thyer", është mënyra se si këto gra, të pëlqefshin apo jo, të futen tërësisht nën lëkurë."

## "HOTELI I BARDHË"

Është një nga romanet më të ... botë, me autor D.M. Thomas, ... në shqip nga Pirro Dollani, ... shtëpia botuese "OMBRA GVG" ... nuk mund të arrijë peizazhin ... "truallin" e këtij romani, ... figurën madhështore të ... Frojdi është një nga karakteret ... në të vërtetë, si zbulues i ... të madh e të bukur, të ... mit, unë nënkuptoj shprehjen ... dramatike të së vërtetës ... duke e theksuar, s'do të thotë ... pikëpyetjeje vlerën shkencore ... analizës. Frojdi në këtë vepër ... figurë krejtësisht artistike. ... Rushdi do ta përkufizonte këtë ... "një forcë përtypyruese dhe ... shkëlqyer".

